ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Policia e Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushëse dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushëse**

Nr1 i prokurimit	**214-24-11421-1-1-1**
Nr i brendshëm	**214/24/163/111**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushëse dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushëse**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"ALBIMI LTD SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gjilan

(Adresa)

Gjilan — *10 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

+38344125959 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ibrahim Krivaqa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

i.krivaqa@albimi.com

(Adresa elektronike)

07.03.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet/ë prokurimit

CamScanner

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 08.11.2024
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 26.12.2024
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 19.02.2025
Kërkesa për rishqyrtim dt.: 23.02.2025
Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt. 27.02.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Jemi njoftuar përmes sistemi elektronik e-prokurimi.

CamScanner

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?.

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

- Kërkesa për rishqyrtim është bërë me datë 23.02.2025 përmes E-prokurimit
- AK-Policia e Kosovë ka nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë 19.02.2025.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 1** Qëllimi
- **Neni 6** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- **Neni 7** Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- **Neni 59** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- **Neni 60** Kriteret për Dhënien e Kontratës
- **Neni 62** i LPP-së
- **Neni 69** Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- **Neni 72** Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

CamScanner

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ankesa është për Furnizim me biçikleta elektrike me bateri rimbushëse-Lot 2, sipas dosjes se tenderit

Me datë 27.02.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me Vendimin e AK-se dhe Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar.

Në këtë letër standarde për eliminim nga aktiviteti i prokurimit janë cekur arsyet si ne vijim:

ARSYETIM
[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :
ALBIMI LTD"SH.P.K.

Ka ofertuar vetëm për pjesën 2:
Në dosjen e tenderit te specifikat teknike është kërkuar : Obligative Biçikletat Elektrike me ri-mbushje duhet të jenë sipas standardeve evropiane që përdoren në BE,
OE edhe pas sqarimit nuk ka arritur te dëshmoje se prodhuesi është sipas standardeve evropiane që përdoren në BE. Anaj oferta juaj eshë e pa përgjegjshme .

Ne si operator ekonomik mendojmë që arsyet e dhena për eliminim të këtij aktiviteti të prokurimit nuk qëndrojnë pasi që ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe këto i kemi kundërshtuar edhe ne kërkesën per rishqyrtim:

Në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, kemi ofruar biçikleta që i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
- Kemi dorëzuar Certifikatën e Baterisë, e cila është në përputhje me standardet e BE-së.
- Kemi ofruar Deklaratën e Konformitetit, që konfirmon se biçikleta i përmbush kushtet e BE-së dhe mund të përdoret në tregun evropian.

Duke qenë se produkti final është i përbërë nga pjesë të certifikuara sipas standardeve të BE-së, kjo tregon qe edhe produkte final i përmbushë standarde, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkua Certifikim specifik por vetëm ka cekur sipas standardeve Evropiane.

Sipas praktikave që i përdorim me klientët në eksport, ne i prodhojmë biçikletat sipas standardeve evropiane dhe e deklarojmë Certifikatën e Konformitetit. Në rastet kur klienti mund të ketë dyshime potenciale, atëher mund ta dërgoj biçikletën për certifikim me koston të cilën e bart klienti, sepse Biçikleta nuk ka nevojë për certifikim shtesë si njësi e tërë, por mbështetet në certifikimin e pjesëve përbërëse.
Ne kemi ofruar dokumentacion të plotë dhe të saktë sipas kërkesave të tenderit. Sipas praktikave të prokurimit publik dhe rregulloreve të BE-së, përdorimi i pjesëve të certifikuara mjafton për të garantuar përputhshmërinë me standardet.
Prandaj refuzimi i ofertës sonë nuk është i bazuar në një vlerësim të drejtë të dokumentacionit të dorëzuar.

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm konstatojmë se AK ka bërë shkelje te neneve përkatëse

CamScanner

si ne vijim:

Pretendimi ankimor 1

- **Neni 1** Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

AK-Policia e Kosovës duke eliminuar ofertën tonë si te pa përgjegjshme edhe pse oferta jonë sipas çmimit qe kemi dorëzuar është dukshëm me e lirë dhe ne harmoni me çmimet e tregut ka shkelur nenin 1 Qëllimi te LPP-së.

Pretendimi ankimor 2

- **Neni 6** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Sipas këtij neni të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

AK-Policia e Kosovës duke eliminuar ofertën me çmim me te lirë nuk ka respektuar ketë nenë dhe ne ketë mënyrë nuk ka bërë shfrytëzim te fondeve publike ne mënyrën me ekonomike, siç kërkohet sipas këtij neni.

Pretendimi ankimor 3

- **Neni 7** Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Eliminimi i ofertës sonë si ofertë e përgjegjshme dhe me çmim me te lirë dëshmon qartë trajtimin jo te barabartë ne mes te operatoreve ekonomik dhe AK-Policia e Kosovës ka bërë diskriminim ndaj ofertës sonë përkatësisht ndaj neve si operator ekonomik me çmim me te lirë.

Pretendimi ankimor 4

- **Neni 59** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Sipas paragrafit 4 te nenit 59 te LPP-së :

1. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose

CamScanner

devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

AK-Policia e Kosovës me datë 31.01.2025 ka kërkuar sqarimet shtesë përmes letrës standarde mbi sqarimin e tenderit si ne vijim:

1.Ne dosjen e tenderit tek specifikat teknike te detyrueshme tek artikulli 8.

Bateria	E integruar ne trup te biçikletës 36V 20Ah 720Wh me certifikate. Minimumi i bateris te jete ne kete amperazh.

Ju lutem na dorëzoni certifikatën sipas specifikave teknike te detyrueshme te kërkuar ne ANEKSIN 1.

2. Në specifikave teknike është kërkuar : Biçikletë Elektrike me bateri ri-mbushëse që përdoret nga EU
Ju lutem te dëshmohet sipas specifikave teknike te detyrueshme.

Ne me datë 05.02.2025 ju kemi dërguar sqarimet shtesë duke bashkangjitur dokumentin me numër UN38.3 TEST REPORT, i cili dëshmon kërkesën sipas autoritetit kontraktues, ky dokument do te jetë pjesë e kësaj ankese.

Përkundër ofrimit te këtij dokumenti AK-Policia e Kosovës nuk ka marrë për bazë dëshminë tonë dhe me datë 14.02.2025 na ka dërguar Letrën Standarde mbi tenderuesin e eliminuar, pikërisht me arsyetimin e eliminimit se ju si prodhues nuk keni arritur të dëshmoni se pajisjet e prodhuesit nuk janë sipas standardeve evropiane qe përdoren në BE.

Andaj nga përshkrimi i mësipërm rezulton qe AK kërkesën për sqarime e ka bërë vetëm sa për te u arsyetuar se kemi kërkuar sqarime shtesë ndërsa ne anën tjetër nuk merr për bazë fare dëshminë e ofruar nga ne.

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm AK-Policia e Kosovës sipas shkeljeve te lartcekura rezulton qe ka bërë edhe shkelje te neneve :

- **Neni 60** Kriteret për Dhënien e Kontratës
- **Neni 62** i LPP-së
- **Neni 69** Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- **Neni 72** Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga **OSHP** që të merr:

VENDIM

TË APROVOHET ankesa e OE **" ALBIMI LTD SH.P.K** si e bazuar
TË ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së i datës 19.02.2025 mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit .
Të kthehet lënda në **RIVLERËSIM**-për Lot 2

DETYROHET autoriteti kontraktues të bëjë rivlerësimin e ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë sepse ne si operator ekonomik i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit per Lot 2 dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

CamScanner

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlera e dëmit kap shumën 30,000.00 Euro të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta paguaj në rast se humb kontekstin Gjyqësor.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
e) Dëshmitë e sqarimeve shtesë

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

CamScanner